



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2022

*Departamenti i Mjekësisë Sociale
Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKSHPK*

RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2022

*Departamenti i Mjekësisë Sociale
Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKShPK*

Botuesi:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Copyright:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Përdorimi i të dhënave lejohet vetëm kur citohet burimi i të dhënave.

Parathënie

Publikimi “Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2022” përfshinë të dhënat në dispozicion të raportuara nga institucionet shëndetësore dhe Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK).

Të dhënat të cilat i shfrytëzojmë për përgatitjen e Raportit të Gjendjes Perinatale nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës edhe për vitin 2022 janë të mangëta, si për Statistikat e Lindjeve dhe Statistikat e vdekjeve, andaj kemi prezentuar lindjet sipas të dhënave nga Departamenti i Statistikave Shëndetësore- IKShPK, dhe të dhënat në dispozicion nga ASK.

Në këtë publikim përfshihen të dhënat mbi definicionet, lindjet dhe vdekshmërinë e foshnjeve të ndarë sipas periudhave të ndryshme të jetës së foshnjeve. Të dhënat kryesore perinatale dhe lindjet janë të prezantuara sipas viteve 2000-2022. Lindjet janë të raportuara sipas niveleve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore publike dhe private. Të porsalindurit janë të prezantuar sipas grup-peshës dhe mënyrës së lindjes. Foshnjat e vdekura janë të prezantuara sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës, statusit martesor dhe nivelit të edukimit të nënës. Koeficienti i vdekshmërisë infantile është prezentuar sipas komunave, kurse koeficienti perinatal në mungesë të dhënave është prezentuar vetëm sipas vitit.

Duke pasë parasysh mangësitë në burime relevante të të dhënave lexuesit dhe ata të cilët do të përdorin këtë hulumtim këshillohen që të marrin me rezervë vlerat e fituara të indikatorëve sepse nuk ilustrojnë në mënyrë të denjë realitetin e gjendjes perinatale në Kosovë.

Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij hulumtimi për bashkëpunim duke dhënë vërejtje, komente dhe propozime me qëllim të ngritjes së cilësisë në këtë lëmi tejet të domosdoshme për zhvillimin, planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor në Kosovë në dobi të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Falenderojmë të gjitha institucionet shëndetësore të Kosovës të cilat ofruan bashkëpunim në mbledhjen e të dhënave.

Prof. Dr. Naser Ramadani, MD., PhD. C.M.I.S., C.I.E.H.

Drejtor ekzekutiv i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	6
PËRMbledhje	7
DEFINICIONET	8
METODOLOGJIA	10
TË DHËNAT KRYESORE	12
LINDJET.....	14
VDEKSHMËRIA E FOSHNJEVER.....	23
VDEKSHMËRIA FETALE.....	27
VDEKSHMËRIA PERINATALE	29
PËRFUNDIMET	31
REKOMANDIMET	33
BIBLIOGRAFIA	34
ANEX	35

PËRMBLEDHJE

Në vitin 2022, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 22,632 foshnje të lindur gjallë, prej tyre 454 jashtë Kosovës. Krahasuar me vitin paraprak (22,830) dallimi i të lindurve gjallë është 198 të lindur gjallë më pakë në vitin 2022.

Sipas Departamentit të Statistikave Shëndetësore në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) në vitin 2022 janë raportuar gjithsej: 20,165 lindje (lehona), foshnje të lindura 20,518; të lindur gjallë 20,385 dhe 133 të lindur vdekur.

Në institucionet shëndetësore në vitin 2022 nga gjithsej lindje, 29.2% të lindjeve janë realizuar me prerje cezariene.

Rëndësia e shëndetit perinatal qëndron në reflektimin e gjendjes shëndetësore të vendit dhe cilësinë e sistemit shëndetësor prandaj si i tillë pë nga rëndësia është paraparë edhe në objektivën e Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë.

Ky raport i dedikohet vendimmarrësve, institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve shëndetësorë me qëllim të identifikimit të situatës, monitorimit të vazhdueshëm si dhe planifikimit të masave specifike adekuate në adresimin e problemeve rreth shëndetit perinatal.

DEFINICIONET

Indikatori Perinatal është indikator kyç dhe senzitiv i gjendjes shëndetësore dhe reflekton kujdesin prenatal, gjatë lindjes dhe kujdesin për të porsalindurit. Poashtu reflekton si indikator i tërthortë për gjendjen shëndetësore të nënës, organizimin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Definicionet e indikatorëve janë shfrytëzuar nga korniza e treguesve të shëndetit të fëmijës dhe nënës e cila është produkt i grupit punues në nivel nacional dhe i përkrahur nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit në Republikën e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, IKShPK dhe UNICEF-i.

I lindur nënkupton shpëputjen e tërësishme e fetusit të vdekur që peshon më shumë se 500 g apo të fetusit të gjallë nga trupi nënës pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë.

I lindur gjallë nënkupton shpëputjen e tërësishme nga trupi i nënës të produktit të konceptimit, pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë, i cili produkt pas ndarjes, merr frymë apo tregon shenja të jetës si p.sh të rrahurat e zemrës, pulsimit të kordonit të kërthizës apo lëvizje vullnetare të muskujve, pavarësisht nëse kordoni i kërthizës është prerë apo placenta është ngjitur.

I lindur vdekur: Vdekja para daljes apo nxerrjes prej nënës së vet e produktit të konceptimit pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shtatzënësisë; vdekja është përcaktuar sipas faktit se pas ndarjes së tillë fetusit nuk merr frymë apo nuk tregon ndonjë shenjë tjetër jete, siç janë rrahjet e zemrës, pulsimit e kordonit umbilikal apo lëvizjet e përcaktuara të muskujve të vullnetshëm (ASK)

Shkalla e të lindurve të vdekur (Vdekshmëria fetale)

Numri i të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur gjallë (të lindur gjallë dhe të lindur të vdekur). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes – gjatë shtatzënësisë dhe gjatë lindjes. Për qëllime të krahasimeve kombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale (≥ 500 g ose ≥ 22 javë). Për qëllime të krahasimeve ndërkombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ($\geq 1,000$ g ose ≥ 28 javë).

Shkalla e vdekshmërisë perinatale

Numri i vdekjeve perinatale (të lindur të vdekur dhe vdekje të hershme neonatale) e shprehur për 1,000 të lindur.

Shkalla e vdekshmërisë neonatale (mortaliteti neonatal) definohet si numri i fëmijëve të lindur të gjallë që vdesin pa i mbushur 28 ditë të jetës (0-27 ditë) e shprehur për 1,000 të lindur gjallë brenda një viti kalendarik.

Vdekjet neonatale (vdekjet gjatë 28 ditëve të para të jetës së foshnjës) mund të ndahen në:

- **vdekjet e hershme neonatale**, që ndodhin brenda 7 ditëve (0-6 ditë) të para të jetës,
- **vdekjet e vonshme neonatale** që ndodhin pas ditës së 7, (7-27 ditë), por para se të përfundohet dita e 28-të.

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil)

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve paraqet numrin e foshnjeve të vdekura para moshës 1 vjeçare (0-11 muaj) të shprehur për 1,000 të lindur të gjallë, në një periudhë të caktuar kohore. Vdekshmëria e foshnjave paraqet probabilitetin që fëmija të vdesë para se t'i mbushë 1 vjet për 1,000 të lindur të gjallë.

Shkalla e vdekshmërisë maternale paraqet numrin e grave të vdekura nga ndonjë shkak që lidhet me (ose është shkaktuar nga) shtatzëninë (duke përjashtuar shkaqe aksidentale apo të rastësishme) dhe vdekjet gjatë lindjes ose brenda 42 ditëve pas përfundimit të shtatzënisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe vendi i shtatzënisë, e shprehur në 100,000 të lindur gjallë, për një periudhë të caktuar kohore.

Vdekje e vonshme maternale është vdekja e një gruaje nga shkaqe të drejtpërdrejta ose të tërthorta më shumë se 42 ditë, por më pak se një vit pas përfundimit të shtatzënisë.

METODOLOGJIA

Për përpilimin e raportit janë përdorur të dhënat për vitin 2022 nga ASK-së për statistikën vitale si dhe të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe të përpiluara në raporte nga Departamenti i Statistikave Shëndetësore në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK).

Regjistrimi dhe grumbullimi i të dhënave për statistikën vitale janë detajuar sipas institucioneve relevante dhe kompetente në çdo fazë të procesit.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave demografike në nivel nacional. IKShPK, gjegjësisht Departamenti i Statistikave Shëndetësore, grumbullon të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe bën raportimin e fenomeneve vitale përmes raporteve nga institucionet shëndetësore relevante ndërsa Departamenti i Mjekësisë Sociale gjegjësisht njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe të Rinjëve bënë analizën e indikatorëve të disagreguar.

- ASK është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave nëpër hapat si më poshtë: çdo institucion shëndetësor dhe zyrë e gjendjes civile ka plotësuar Fletëzat statistikore për vdekje DEM-2
- Në baza mujore, institucionet shëndetësore dhe zyrat e gjendjes civile kanë raportuar në zyrat regjionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), duke dorëzuar kopjet fizike të të gjitha DEM-2 të plotësuar.
- Zyrat regjionale të ASK, me pasqyrën mujore të të dhënave për lindje dhe vdekje DEM-5, kanë raportuar në ASK.
- Departamenti i statistikave sociale – sektori i statistikave vitale në ASK, ka kontrolluar cilësinë dhe ka konfirmuar të gjitha të dhënat.
- Të gjitha të dhënat janë futur në programin Access në Departamentin e IT-së.
- Sektori i statistikave vitale ka kontrolluar të dhënat në databazën e vdekjeve dhe ka përpunuar të dhënat me SPSS.
- ASK ka publikuar në faqen e internetit raportin “Statistikat e vdekjeve”
- Grumbullimin e të dhënave nga institucionet shëndetësore relevante e realizon Departamenti i statistikave shëndetësore në IKShPK, kalkulimin e indikatorëve të disagreguar sipas gjinisë, komunave, moshës si dhe prezantimin e trendit e ka realizuar, Departamenti i Mjekësisë Sociale, Njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe të Rinjëve.

Sfidat në grumbullimin e të dhënave:

- Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) një nga sfidat kryesore është mungesa e pyetësorit të standardizuar nga tri institucionet (Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Ministria e Shëndetësisë, IKShPK).
- Gjatë vitit 2019/2020 është punuar në unifikimin e formularit për raportim, megjithatë të dhënat nga ASK për vitin 2022 për lindje dhe vdekje nuk janë të kompletuara edhe pas publikimit të fundit, prandaj në raportin e gjendjes Perinatale për vitin 2022, në mungesë të të dhënave disa indikatorë të agreguar kanë diskrepancë krahasuar me vitet paraprake si dhe disa indikatorë tjerë nuk kemi pasë mundësi t'i kalkulojmë sipas gjinisë dhe komunave.
- Numri i banorëve është bazuar në prognozën e fundit të popullatës, 2022(ASK)
- Përkundër ekzistimit në fuqi të qarkores për raportim të vdekjeve maternale, si dhe kërkesës së vazhdueshme për raportim edhe në vitin 2022 asnjë vdekje maternale nuk është raportuar nga institucionet shëndetësore. Në vitin 2022 në mungesë të të dhënave nuk ka reflektim të këtij indikator në Raportin Perinatal.
- Përfshirja në raportim e vdekjeve fetale sipas komunave të Kosovës është sfidë tjetër për tu adresuar pasi që nuk ka të dhëna nga ASK.
- Mungesa e analizimit të shkaqeve të vdekjeve për vitin 2022 në nivel nacional për arsye të vonës së publikimit gjë që reflekton në orientimin e masave intervenuese.
- Mortaliteti perinatal si indikator ndikohet prej faktorëve tjerë jashtë sistemit shëndetësor dhe jo vetëm brenda kujdesit shëndetësor.
- Në Raportin Perinatal për vitin 2022 janë përfshirë vetëm disa prej indikatorëve bazikë dhe vazhdon të mbetet ende sfidë për Kosovën gjenerimi i indikatorëve të shëndetit perinatal sipas instrumentit Europian EURO-PERISTAT.

TË DHËNAT KRYESORE

Të dhënat perinatale kryesore për vitin 2022 në Kosovë, të raportuara nga institucionet shëndetësore publike dhe private në Departamentin e Statistikave Shëndetësore - IKShPK janë:

- 20,165, lindje (lehona)
- 21,518, foshnje të lindura
- 20,385 të posalindur gjallë
- 133 të lindur vdekur
- raporti gjinor në lindje është 1045.2 meshkuj në 1,000 femra
- shkalla e lindjeve me prerje cezariene është 29.2 % .

Tabela 1. Të dhënat kryesore perinatale për vitin 2022

Nr	Modalitetet	2022
3	Numri i të posalindurve të lindur të gjallë	22,632
4	Numri i vdekjeve fetale	133
	Numri i foshnjave të vdekura(<1 vjet)	117
5	Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	6.5
6	Shkalla e vdekshmërisë infantile (‰)	5.2
7	Numri i foshnjave të vdekura në javën e parë	82
8	Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	3.6
9	Shkalla e mortalitetit të vonshëm neonatal (‰)	0.8
10	Shkalla e mortalitetit post neonatal (‰)	0.8
11	Shkalla e vdekshmërisë perinatale (‰)	10
12	Shkalla e lindjeve me prerje cezariene (‰)	29.2

Burimi: ASK- Statistikat e lindjeve, vdekjeve, 2022

Departamenti i Statistikave Shëndetësore- IKShPK, Statistikat e lindjeve, 2022

Tab.2.Të dhënat kryesore perinatale për periudhën, 2000-2022

Vitet	Të dhënat kryesore perinatale, 2000-2022							
	Numri i lindjeve	Numri i të porsalindurve të lindur të gjallë	Numri i vdekjeve fetale	Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	Numri i foshnjeve të vdekura në javën e parë	Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	Shkalla e vdekshmërisë perinatal e (‰)	Shkalla e lindjeve me prerje cezariane (%)
2000	39,091	38,907	572	14.5	577	14.8	29.1	7.5
2001	39,578	39,506	579	14.4	574	14.5	28.7	9.1
2002	35,399	35,271	527	14.7	444	12.6	27.1	10.3
2003	31,932	31,815	517	15.9	375	11.8	27.6	11.3
2004	30,925	30,852	452	14.4	352	11.4	25.6	12.3
2005	29,056	29,055	390	13.3	262	9.02	22.1	13.9
2006	28,404	28,450	360	12.5	307	10.8	23.2	16.4
2007	27,856	27,972	319	11.3	247	8.8	20.0	17.7
2008	28,178	28,317	334	11.6	257	9.1	20.6	18.2
2009	27,718	27,833	276	9.8	267	9.6	19.3	20.1
2010	27,517	27,645	318	11.4	216	7.8	19.1	20.7
2011	27,548	27,725	252	9.0	248	8.9	17.9	21.8
2012	28,525	28,664	284	9.8	218	7.6	17.3	20.9
2013	27,069	27,277	278	10.1	170	6.2	16.3	25.2
2014	26,565	26,787	226	8.4	98	3.7	12.0	26.9
2015	24,611	24,812	177	7.1	126	5.0	12.1	27.3
2016	24,092	24,697	156	6.3	121	4.9	11.2	24.3
2017	23,563	23,402	161	6.8	132	5.6	12.4	19.0
2018	22,870	22,761	109	4.8	147	6.6	11.2	18.2
2019	21,899	21,798	101	4.6	118	5.4	10.0	20.7
2020	20,781	20,988	135	6.4	43	1.9	8.0	21.0
2021	20,654	22,830	116	5.1	64	2.8	7.9	26.5
2022	20,165	22,632	133	6.5	82	4	10	29.2

Burimi: Raporti i gjendjes perinatale 2010

ASK: Statistikat e lindjeve dhe vdekjeve, 2011-2022

Departamenti i Statistikave Shëndetësore- IKShPK

LINDJET

Në vitin 2022, sipas të dhënave të ASK-së, janë raportuar gjithsej 22,632 të lindur gjallë, prej tyre 454 të lindur jashtë Kosovës, të lindur vdekur nuk janë raportuar.

Sipas IKShPK-së janë raportuar gjithsej 20,165 lindje (lehona), 21,518, foshnje të lindura, 20,385 të lindur gjallë dhe 133 të lindur vdekur. Numri i të lindurve gjallë më i lartë se numri i lehonave (lindjeve) spjegohet me faktin se fëmijët e lindur kanë qenë bineq apo treneq. Diferenca e numrit të të lindurve gjallë të raportuar nga ASK dhe IKShPK për vitin 2022 është 2,247 të lindur gjallë, (tab.3).

Tab.3. Raportimi i të dhënave nga dy burime të të dhënave

Institucioni	Foshnje të lindur gjallë	Të lindur vdekur
IKShPK	20,385	133
ASK	22,632	-
Diferenca	2,247	

Burimi: IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2022

ASK: Statistikat e Lindjeve 2022

Bazuar në raportin e IKShPK- së, për vitin 2022 gjithsej lindje ishin 20,165, dhe sipas nivelit të kujdesit shëndetësor ku janë kryer lindjet janë si në vijim: Përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në Spitalet e përgjithshme me 10,500 apo 52.1%, pason Klinika Obstetrike Gjinekologjike e QKUK-së me 8,808 lindje apo 43.7%, në maternitete 82 lindje apo 0.4%, ndërsa në spitalet private (Bahceci, Amerikan, Lindja, Sirona, European Klinik dhe Fati im) 775 lindje apo 3.8%. Në institucionet publike janë realizuar gjithsej 19,390 apo 96.2% e lindjeve, (tab.4,5, graf.1).

Tab.4. Lindjet sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, institucionit, Kosovë- 2022


Institucioni	Gjithsej lindje (Lehona)		Gjithsej foshnje të lindura		Prej tyre të lindura gjallë		Prej tyre të lindura pa jetë	
	N	%	N	%	N	%	N	%
QKUK	8,808	43.7	9066	44.2	8,967	44.0	99	74.4
Spitali	10,500	52.1	10,570	51.5	10541	51.7	29	21.8
Maternitetet jashtëspitalore	82	0.4	83	0.4	83	0.4	0	0.0
Institucione publike	19,390	96.2	19,719	96.1	19,591	96.1	128	96.2
Institucione private	775	3.8	799	3.9	794	3.9	5	3.8
Gjithsej	20,165	100.0	20,518	100.0	20,385	100.0	133	100.0

Burimi: IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2022

Tab.5. Lindjet në nivelin parësor shëndetësor, Kosovë- 2022

Institucioni	Komuna	Lindje (Lehona)		Foshnje të lindura		Prej tyre të lindura gjallë		Të lindura pa jetë	
		N	%	N	%	N	%	N	%
Materniteti jashtëspitalor	Deqan	0	0.00	0	0.00	0	0.00	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Dragash	8	0.04	8	0.04	8	0.04	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Drenas	10	0.05	10	0.05	10	0.05	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Istog	5	0.02	5	0.02	5	0.02	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Kamenica	0	0.00	0	0.00	0	0.00	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Kline	0	0.00	0	0.00	0	0.00	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Lipjan	4	0.02	4	0.02	4	0.02	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Malisheve	0	0.00	0	0.00	0	0.00	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Podujevë	7	0.03	7	0.03	7	0.03	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Rahovec	24	0.12	24	0.12	24	0.12	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Skenderaj	1	0.00	1	0.00	1	0.00	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Suhareke	23	0.11	24	0.12	24	0.12	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Viti	0	0.00	0	0.00	0	0.00	-	-
Materniteti jashtëspitalor	Kaçanik	0	0.00	0	0.00	0	0.00	-	-
Totali		82	0.41	83	0.40	83	0.41	-	-

Burimi: IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2022




Graf.1 Struktura e lindjeve në institucionet publike dhe private, 2022

Burimi: IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2022

Tab.6 Të lindurit gjallë sipas gjinisë, shkalla e maskulinitetit

Institucioni	Komuna	Gjinia				TOTALI		Shkalla e maskulinitetit në 1000
		Djem		Vajza				
		N	%	N	%	N	%	
TOTALI		10,418	51.1	9,967	48.9	20,385	100.0	1045.2

Burimi: IKShPK - Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2022




Graf.2. Struktura e të lindurve gjallë sipas gjinisë

Burimi: IKShPK - Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2022

Sipas të dhënave nga Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2022 gjithsej ishin 20,385 të lindur të gjallë prej tyre, femra 9,967 (48.9%), meshkuj 10,418 (51.1%) me koeficient të maskulinitetit në lindje 1045.2‰, (tab.6, graf.2).

Sipas të dhënave nga ASK, sipas komunave më së shumti të lindur gjallë kishte në komunën e Prishtinës me 2,831 apo (12.5%) komunën e Prizrenit me 1,924 apo (8.5%) dhe komunën e Ferizajit me 1,526 apo (6.7%). Komunat me numrin më të vogël të të lindurve gjallë me 0.1% ishin: komuna e Junikut, Ranillugës, Parteshit, (graf.3).




Graf.3. Struktura e të lindurve gjallë sipas komunave, 2022

Burimi: ASK-Statistikat e Lindjeve, 2022

Trendi i lindjeve

Trendi i lindjeve për periudhën kohore 2000-2022 tregon ecuri të rënies së numrit të lindjeve me lëvizje variable me mesatare 0.9 %, (graf.4).




Graf.4. Trendi i lindjeve, Kosovë 2000-2022

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë

Trendi i natalitetit


Lindshmëria gjatë viteve 2000-2022 tregon trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare 0.6%. Lindshmëria për 1,000 banorë apo nataliteti në vitin 2000 ishte 19.3%, ndërsa në vitin 2022 ishte 12.8 %, (graf.5).



Graf.5. Trendi i natalitetit, Kosovë 2000-2022

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë

Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në Klinikën Gjinekologjike Obsterike të QKUK-së me 24.1 lindje në ditë, pason Prizreni me 7.4 lindje, Gjakova me 4.6 lindje, Peja me 4.3 lindje, dhe më së paku lindje në Vushtrri me 1 lindje në ditë, (graf.6).



Graf.6. Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore


Burimi: IKShPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2022

Sa i përket të porsalindurve sipas peshës trupore në lindje me pjesëmarrje më të madhe ishte grup pesha 2500-3999g me 86.2 % dhe grup pesha 4000+g me 8.9 %. Pjesëmarrje më të vogël në lindje kishte grup pesha më pak se 1000g me 0.5%. Pesha mesatare e të posalindurve gjallë ishte 3279.1 gram, (tab.7, graf.7).

Tab.7. Numri i foshnjeve të lindura gjallë sipas peshës trupore në institucionet publike dhe private, në vitin 2022

Komuna / Institucioni	Pesha trupore					Gjithsej	Pesha mesatar e
	Nën 1000	1000-1499	1500-2499	2500-3999	4000+		
N	111	242	657	17564	1807	20385	3279.1
%	0.5	1.2	3.2	86.2	8.9	100.0	-

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2022



Graf.7. Përqindja e foshnjave të lindura gjallë sipas grup peshave për vitin 2022

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2022

Sipas grup-moshës së nënës pjesëmarrja më e lartë e të lindurve gjallë janë nga nënat e grup-moshës 25-29 vjet me 7,506 apo (33.2%), pasojnë të lindurit gjallë nga nënat e grup-moshës 30-34 vjet me 6,867apo (30.3%). Mosha mesatare e nënave ka qenë mosha 29 vjeçe, (tab.8).

Tab.8. Të lindurit gjallë sipas grup-moshave të nënës, 2022

Grup moshë e nënës										Mosha mesatare
14 e më pak	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50 e më shumë	Gjithsej	
N	1	414	3,695	7,506	6,867	3,220	825	87	17	22,632
%	0.0	1.8	16.3	33.2	30.3	14.2	3.6	0.4	0.1	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2022

Në vitin 2022 sipas të dhënave të ASK-së nga gjithsej 22,632 të lindur gjallë, 21,932 apo (96.9%) prej tyre kishin lindur nga një foshnje, 700 apo (3.1%) kanë lindur binjak dhe nuk është raportuar asnjë lindje trenjak, (tab.9).

Tab.9. Foshnje të lindura sipas numrit

Fëmijë të lindur	Një	21,932	96.9
	Binjak	700	3.1
	Trenjak	0	0.0
	Gjithsej	22,632	100.0


Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2022

Në institucionet shëndetësore nga gjithsej 20,165 lindje të raportuara, 5,896 prej tyre apo (29.2%) lindje janë realizuar me prerje cezariene. Në institucionet publike, 5,228 lindje apo (27.0%) janë realizuar me prerje cezariene ndërsa në institucionet private nga gjithsej 775 lindje 668 apo (86.2%) janë realizuar me prerje cezariene, (tab.10,11, graf.8).

Tab.10. Struktura e lindjeve sipas mënyres së lindjes, për vitin 2022

Mënyra e Lindjes	N	%
Lindje normale	14,269	70.8
Lindje me prerje cezariene	5,896	29.2
Gjithsej lindje	20,165	100.0

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës, 2022



Graf.8. Struktura e lindjeve sipas mënyres së lindjes, për vitin 2022

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës, 2022

Në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së, 1,700 apo (19.3%) e lindjeve janë me prerje cezariene. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariene është realizuar në spitalin e Pejës 660 (42.5%), pason spitali i Prizrenit 1,025 apo 37.7% dhe spitali me më pak raste të raportuara të lindjeve me prerje cezariene ishte spitali i Ferizajit me 188 apo (14.7%). Spitalet private nga gjithsej 775 lindje të raportuara 668 apo (86.2%) prej tyre janë realizuar me prerje cezariene, (tab.10).


Në graf.10 është analizuar ecuria e lindjeve me prerje cezariene për periudhën 2000-2022, ku shifet se lindjet me prerje cezariene kanë pësuar rritje përgjatë viteve, sidomos në vitin 2015 ishte përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariene (27.3%), pason një rënie në vitin 2017, 2018 dhe prapë kemi ngritje të lehtë deri në vitin 2020.

Në vitin 2021, 2022 kemi ngritje më të theksuar, sidomos në vitin 2022 ku 29.2% të lindjeve janë realizuar me prerje cezariene. Në institucionet private përqindja e lindjeve të realizuara me prerje cezariene është shumë e lartë 86.2%, (tab.11, graf.9,10).

Tab.11. Lindjet me prerje Cezariane sipas institucioneve shëndetësore, Kosovë 2022


			Lindje Normale		Lindje me prerje cezariane		Gjithsej Lindje
			N	%	N	%	N
Institucionet Publike	QKUK	Prishtinë	7,108	80.7	1,700	19.3	8,808
	Spitali	Ferizaj	1,092	85.3	188	14.7	1,280
	Spitali	Gjakove	1,220	72.0	475	28.0	1,695
	Spitali	Gjilan	892	64.0	502	36.0	1,394
	Spitali	Mitrovice	1,013	62.9	598	37.1	1,611
	Spitali	Pejë	893	57.5	660	42.5	1,553
	Spitali	Prizren	1,693	62.3	1,025	37.7	2,718
	Spitali	Vushtrri	169	67.9	80	32.1	249
	Maternitete jashtëspitalore		82	100.0	0	0.0	82
Gjithsej në Institucione Publike			14,162	73.0	5,228	27.0	19,390
Institucionet Private	Bahceci Healthcare		0	0	0	0.0	0
	Spitali Amerikan Kosove		41	9.4	395	90.6	436
	Spitali Sirona/Olive		26	22.8	88	77.2	114
	European Clini" Spital privat gjinekologjik/obstetri		37	25.7	107	74.3	144
	"FATI IM" Spital privat gjinekologjik/obstetrik		0	0.0	0	0.0	0
	"Dream Hospital"		3	3.7	78	96.3	81
Gjithsej në Institucione Private			107	13.8	668	86.2	775
TOTALI			14,269	70.8	5,896	29.2	20,165

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës për vitin 2022



Graf.9. Struktura e lindjeve sipas mënyrës së lindjes në dhe llojit të institucioneve shëndetësore

Burimi: IKShPK – Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës për vitin 2022



Graf.10. Struktura e lindjeve me prerje cezariane për vitet, 2000-2022

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës

VDEKSHMËRIA E FOSHNJAVE

Vdekshmëria e foshnjave apo mortaliteti infantil është një nga indikatorët e ndikimit (impaktit) sepse reflekton sistemin shëndetësor, kujdesin antenatal, natal dhe pasnatal, kulturën shëndetësore dhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror të vendit.


Ky indikator paraqet numrin e foshnjave të vdekura prej 0-364 ditë për 1000 lindje të gjalla për një vit në vend.

Sipas të dhënave nga ASK, gjatë vitit 2022 institucionet shëndetësore kanë raportuar gjithsej 117 foshnje të vdekura, prej tyre 82 apo (70.1%) janë foshnje të vdekura prej 0-6 ditë, 18 apo (15.4%) janë foshnje të vdekura prej 7-27 ditë dhe 17 apo (14.5%) janë foshnje të vdekura prej 1-11 muaj, (tab.12, graf 11).

Tab.12. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës

Foshnje të vdekura	Deri në 24 orë	1 – 6 ditë	7 – 27 ditë	1 – 11 muaj	Gjithsej
N	43	39	18	17	117
%	36.8	33.3	15.4	14.5	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2022




Graf.11. Struktura e vdekshmërisë së foshnjave sipas moshës

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2022

Sipas të dhënave të ASK-së, mortaliteti infantil në vitin 2022 ishte 5.2%, kurse në vitin paraprak vlera e këtij indikatori ishte 4.4%.


Shkalla e mortalitetit infantil për periudhën 2002-2022 tregon rënie me lëvizje variabile me mesatare prej 0.6%, (graf.12).



Graf.12. Mortaliteti infantil, 2002-2022


Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2022

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave sipas moshës për vitin 2022 është si vijon: Mortaliteti neonatal i hershëm 3.6%, mortaliteti neonatal i vonshëm 0.8% dhe mortaliteti postneonatal 0.8%, (graf.13).



Graf.13. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2022




Graf.14. Vdekshmëria e foshnjave sipas gjinisë

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2022

Mortaliteti infantil sipas gjinisë ishte 3.0‰ për meshkuj dhe 2.2‰ për femra (graf.14)

Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale për vitet; 2000-2022 ka pësuar rënje me lëvizje variabile me mesatare prej 0.9‰, (graf.15).



Graf.15. Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2022

Në vitin 2022 nga gjithsej 117 foshnje të vdekura, 67 prej tyre janë meshkuj dhe 50 femra. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës së nënës dominon mosha 25-34 vjet me 69 foshnja të vdekura.(tab.13).

Tab.13. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës

Modalitete		Gjithsej	Moshë e foshnjave të vdekura		
			0-6 ditë	7-27 ditë	28-364 ditë
Gjinia	Meshkuj	67	44	13	10
	Femëra	50	38	5	7
	Gjithsej	117	82	18	17
Moshë	15-24	17	9	4	4
	25-34	69	51	10	8
	35+	31	22	4	5
Gjithsej		117	82	18	17
%		100.0	70.1	15.4	14.5

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2022

VDEKSHMËRIA FETALE

Vdekshmëria fetale paraqet numrin e të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur gjallë (të lindur gjallë dhe të lindur të vdekur). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes, gjatë shtatzënësisë dhe gjatë lindjes.

Në vitin 2022 sipas IKShPK-së, departamentit të Statistikave Shëndetësore, numri i foshnjave të lindura pa jetë ka qenë 133, me vdekshmëri fetale 6.5%.


Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 99 vdekje fetale (74.4%) kanë ndodhë në QKUK, 29 apo (21.8%) në spitale, në institucione private janë raportuar 5 raste të lindura pa jetë apo 3.8%, (tab.14).

Tab.14. Foshnjat e lindura pa jetë sipas institucioneve shëndetësore, 2022

Nr	Institucioni	Prej tyre të lindur pa jetë	
		N	%
1	QKUK	99	74.4
2	Spitalet e përgjithshme	29	21.8
3	Maternitetet jashtëspitalore	0	0.0
4	Institucionet publike	128	96.2
5	Institucionet private	5	3.8
6	Gjithsej	133	100.0

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2022

Sipas të dhënave të raportuara në departamentin e Statistikave Shëndetësore, në nivelin terciar në QKUK, në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, vdekshmëria fetale është më e larta me 11%. Sa i përket spitaleve rajonale, spitalet me shkallën më të lartë të vdekshmërisë fetale janë: spitali i Gjilanit me 6.4% dhe Pejës me 3.7%. Spitali i Ferizajit dhe Vushtrrisë nuk kanë raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale, (tab.13, graf.16).



Graf.16. Vdekshmëria fetale sipas institucioneve shëndetësore publike

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2022

Vdekshmëria fetale për periudhën 2000-2022 ka trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.7%. Në vitin 2000 shkalla e vdekshmërisë fetale ishte 14.5% ndërsa në vitin 2022 është 6.5%, që tregon se është punuar në përmirësimin e gjendjes perinatale gjatë viteve, (graf.17).



Graf.17. Shkalla e vdekshmërisë fetale, 2000-2022


Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2022

VDEKSHMËRIA PERINATALE

Vdekshmëria perinatale pasqyron vdekshmërinë fetale dhe vdekshmërinë e hershme neonatale së bashku për një periudhë të caktuar kohore në territor të caktuar.

Në vitin 2022 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 10.1‰ (vdekshmëria fetale 6.5‰ dhe vdekshmëria e hershme neonatale 3.6‰), dallimi me vitin paraprak ishte 2.2‰ që është dallim shumë i ndjeshëm.

Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2000-2022 tregon tendencë të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 1‰, (graf.17).



Graf.17. Trendi i mortalitetit perinatal, 2000-2022

Burimi: Raporti i gjendjes perinatale, 2010

ASK, Statistikat e Vdekjeve dhe lindjeve 2000-2022

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (‰) sipas moshës për vitin 2022:

Vdekshmëria e hershme neonatale (0 – 6 ditë) 3.6‰.

Vdekshmëria neonatale e vonshme (7 – 27 ditë) 0.8‰.

Vdekshmëria postneonatale (28-364 ditë) 0.8‰.

Tab.15. Indikatorët demografikë në Kosovë sipas komunave, 2022

Komuna	Nataliteti	Mortaliteti	Mortaliteti infantil	Shtimi natyror
Deçan	8.2	4.8	14.3	-1.3
Gjakovë	11.3	6.1	4.8	-0.9
Glllogoc	14.3	3.8	1.2	6.8
Gjilan	15.4	8.1	7.4	-0.9
Dragash	8.1	6.0	0.0	-4.0
Istog	10.5	5.5	4.6	-0.6
Kaçanik	12.2	4.4	4.7	3.3
Klinë	11.7	4.8	6.4	2.0
Fushë Kosovë	17.8	5.3	5.7	7.2
Kamenicë	11.6	9.4	0.0	-7.2
Mitrovicë Jugore	13.7	6.5	4.3	0.8
Mitrovicë Veriore	4.5	4.8	0.0	-5.1
Leposaviq	15.2	4.4	0.0	6.5
Lipjan	14.3	9.6	0.0	-4.9
Novobërdë	23.1	7.2	2.5	8.6
Obiliq	12.2	4.7	3.0	2.9
Rahovec	10.8	6.0	5.8	-1.2
Pejë	13.5	5.2	12.1	3.0
Podujevë	13.0	4.9	6.7	3.1
Prishtinë	9.9	4.7	3.6	0.5
Prizren	12.0	5.0	4.7	1.9
Skënderaj	16.7	5.6	4.4	5.5
Shtime	17.6	19.7	9.0	-21.7
Shtërpçë	11.8	5.6	4.5	0.6
Suharekë	14.6	5.5	9.8	3.7
Ferizaj	11.3	5.0	3.7	1.2
Viti	16.0	6.2	4.1	3.7
Vushtrri	10.4	6.8	0.0	-3.1
Zubin Potok	6.8	9.7	0.0	-12.7
Zveçan	13.3	3.9	5.4	5.5
Malishevë	5.9	5.2	0.0	-4.4
Junik	13.3	4.0	0.0	5.3
Mamushë	11.3	4.1	8.8	3.2
Hani i Elezit	12.1	11.8	0.0	-11.5
Graçanicë	7.2	11.5	0.0	-15.8
Ranillug	14.5	21.7	0.0	-28.9
Partesh	14.1	10.4	0.0	-6.7
Klllokot	13.1	11.2	0.0	-9.3
Gjithsej	12.8	5.6	5.2	7.3

Burimi: ASK: Vlerësim popullsia e Kosovës, 2022

Statistikat e Lindjeve dhe statistikat Vdekjeve, 2022

PËRFUNDIMET

- Në vitin 2022, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 22,632 foshnje të lindura gjallë, prej tyre 454 jashtë Kosovës.
- Sipas të dhënave të Departamentit të Statistikave Shëndetësore, në vitin 2022 prej gjithsej lindjeve në Kosovë, 20,385 ishin të lindur gjallë dhe 133 të lindur vdekur.
- Sipas gjinisë të të porsalindurve, të gjinisë mashkullore ishin 10,418 apo (51.1%), femra 9,967 apo (48.9%), raporti gjinor në lindje ishte 1045.2 meshkuj në çdo 1,000 femra të lindura gjallë.
- Në vitin 2022, në institucionet shëndetësore 29.2% të lindjeve janë kryer me prerje cezariene.
- Bazuar në raportin e IKShPK- së, për vitin 2022, përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në Spitalet e përgjithshme me 10,500 apo 52.1%, pason Klinika Obstetrike Gjinekologjike e QKUK-së me 8,808 lindje apo 43.7%, në maternitete 82 lindje apo 0.4%, ndërsa në spitalet private (Bahceci, Amerikan, Lindja, Sirona, European Klinik dhe Fati im) 775 lindje apo 3.8%. Në institucionet publike janë realizuar gjithsej 19,390 apo 96.2% e lindjeve, (tab.4, graf.1).
- Sipas komunave më së shumti të lindur gjallë kishte në komunën e Prishtinës me 2,831 apo (12.5%) komunën e Prizrenit me 1,924 apo (8.5%) dhe komunën e Ferizajit me 1,526 apo (6.7%). Komunat me numrin më të vogël të të lindurve gjallë me 0.1% ishin: komuna e Junikut, Ranillugës dhe Parteshit
- Lindshmëria gjatë viteve 2000-2022 tregon trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.6‰.
- Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së me 24.1 lindje, pason Peja 7.4 lindje, Gjakova me 4.6 lindje, Prizreni me 4.3 lindje në ditë. Më së paku lindje kishte në Vushtrri me 1 lindje në ditë.
- Sa i përket të porsalindurve sipas peshës trupore në lindje me pjesëmarrje më të madhe ishte grup pesha 2500-3999g me 86.2 % dhe grup pesha 4000+g me 8.9 %. Pjesëmarrje më të vogël në lindje kishte grup pesha më pak se 1000g me 0.5%. Pesha mesatare e të posalindurve gjallë ishte 3279.1 gram
- Mosha mesatare e nënave është mosha 29 vjeçare.
Në institucionet shëndetësore nga gjithsej 20,165 lindje të raportuara, 5,896 prej tyre apo (29.2%) lindje janë me prerje cezariene. Në institucionet publike, 5,228 lindje apo (27.0%) janë me prerje cezariene ndërsa në institucionet private nga gjithsej 775 lindje 668 apo (86.2%) janë me prerje cezariene. Në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së, 1,700 apo (19.3%) e lindjeve janë me prerje cezariene. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariene është realizuar në spitalin e Pejës 660 (42.5%), pason spitali i Prizrenit 1,025 apo 37.7% dhe spitali me më pak raste të raportuara të lindjeve me prerje cezariene ishte spitali i Ferizajit me 188 apo (14.7%). Spitalet private nga gjithsej 775 lindje të raportuara 668 apo (86.2%) prej tyre me prerje cezariene.

- Sipas të dhënave nga ASK, gjatë vitit 2022 institucionet shëndetësore kanë raportuar gjithsej 117 foshnje të vdekura. Prej tyre 82 apo (70.1%) janë foshnje të vdekura prej 0-6 ditë, 18 apo (15.4%) janë foshnje të vdekura prej 7-27 ditë dhe 17 apo (14.5%) janë foshnje të vdekura prej 1-11 muaj.
- Mortaliteti infantil në Kosovë për vitin 2022 është 5.2‰. Shkalla e vdekshmërisë sipas moshës është si vijon: Mortaliteti neonatal i hershëm 3.6‰, mortaliteti neonatal i vonshëm 0.8‰ dhe mortaliteti postneonatal 0.8‰.
- Mortaliteti infantil për periudhën 2002-2022 tregon rënie me lëvizje variabile me mesatare 0.5‰.
- Në vitin 2022 sipas IKShPK-së, Departamentit i Statistikave Shëndetësore, numri i foshnjave të lindura pa jetë ka qenë 133, me vdekshmëri fetale prej 6.5‰.
- Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 99 vdekje fetale (74.4%) kanë ndodhë në QKUK, 29 apo (21.8%) në spitale, ndërsa në institucione private janë raportuar 5 raste të lindura pa jetë apo 3.8%.
- Vdekshmëria fetale për periudhën 2000-2022 ka trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.69‰.
- Në vitin 2022 shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 10.1‰.
- Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2000-2022 tregon tendencë të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 1‰.

REKOMANDIMET

- Urgjentisht në grumbullimin dhe raportimin e të dhënave perinatale të përfshihen të gjitha institucionet, publike dhe private si dhe të gjitha komunat.
- Në grumbullimin dhe raportimin e të dhënave perinatale urgjentisht të përfshihen të gjitha institucionet, publike dhe private si dhe të gjitha komunat.
- Të zbatohet në praktikë pyetësi i unifikuar për mbledhjen e të dhënave mes institucioneve relevante.
- Urgjentisht të sigurohet niveli i raportimit të të dhënave për vdekjet maternale dhe shkaqet e vdekjeve të foshnjave.
- Të organizohen trajnime të punëtorëve shëndetësorë për kodimin e shkaqeve të vdekjeve.
- Të fuqizohet qasja multidisiplinare në përmirësimin e kujdesit prenatal, kujdesit natal përmes organizimit të aktiviteteve sipas pakos së OBSH-së “Every Newborn action plan to end preventable deaths”.
- Të hartohen udhërrëfyesit dhe protokolet klinike relevante dhe të monitorohet zbatimi i tyre në praktikë.
- Të realizohet vlerësimi i cilësisë së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Planifikimi të bëhet konform të gjeturave nga vlerësimi i performancës së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të fuqizohet më tutje edukimi i vazhdueshëm profesional i punëtorëve shëndetësor.
- Të zgjerohet programi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë në të gjitha komunat e Kosovës.
- Të përmirësohet infrastruktura, pajisjet dhe furnizimi me barna në institucione që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të organizohen takime të rregullta profesionale multidisiplinare për të prezantuar dhe diskutuar çështjet për kujdesin shëndetësor të nënës dhe fëmijës.
- Të përforcohet koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të autoriteteve qeveritare shëndetësore qendrore dhe atyre lokale, organizatave qeveritare dhe joqeveritare si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, asociacioneve të tjera profesionale dhe shoqërisë civile.
- Të punohet në ngritjen e nivelit të njohurive për shëndetin e nënës dhe fëmijës përmes programeve dhe aktiviteteve të promovimit dhe edukimit shëndetësor në Kosovë.
- Të përkrahet edukimi shëndetësor për shtatzënat, prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes.

BIBLIOGRAFIA

1. IKSHPK, Raporti i lindjeve në institucionet shëndetësore për vitin 2022
2. ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2022
3. ASK, Statistikat e Vdekjeve në Kosovë, 2022
4. ASK, Vlersim popullsia e Kosovës, 2022
5. Raporti i gjendjes perinatale, 2010
6. Raporti i gjendjes perinatale, 2012
7. Raporti i gjendjes perinatale, 2021

ANEKS

Të dhënat demografike, 2022-Kosovë

Komuna	Banorë	Lindur gjallë	Vdekur	Vdekje më pak se 1 vit	Nataliteti	Mortaliteti	Mortaliteti infantil	Shtimi natyror
Deçan	42,642	349	203	5	8.2	4.76	14.3	-1.3
Gjakovë	92,021	1039	561	5	11.3	6.10	4.8	-0.9
Gillogoc	60,518	863	227	1	14.3	3.75	1.2	6.8
Gjilan	70,587	1085	574	8	15.4	8.13	7.4	-0.9
Dragash	33,218	268	200	0	8.1	6.02	0.0	-4.0
Istog	41,348	435	229	2	10.5	5.54	4.6	-0.6
Kaçanik	34,753	424	154	2	12.2	4.43	4.7	3.3
Klinë	40,164	469	194	3	11.7	4.83	6.4	2.0
Fushë Kosovë	39,112	698	209	4	17.8	5.34	5.7	7.2
Kamenicë	24,675	287	232	0	11.6	9.40	0.0	-7.2
Mitrovicë Jugore	67,652	929	437	4	13.7	6.46	4.3	0.8
Mitrovicë Veriore	12,828	58	62	0	4.5	4.83	0.0	-5.1
Leposaviq	57,242	872	251	0	15.2	4.38	0.0	6.5
Lipjan	6,993	100	67	0	14.3	9.58	0.0	-4.9
Novobërdë	17,251	398	125	1	23.1	7.25	2.5	8.6
Obiliq	54,750	669	256	2	12.2	4.68	3.0	2.9
Rahovec	96,136	1037	574	6	10.8	5.97	5.8	-1.2
Pejë	79,631	1075	418	13	13.5	5.25	12.1	3.0
Podujevë	217,816	2831	1075	19	13.0	4.94	6.7	3.1
Prishtinë	195,326	1924	916	7	9.9	4.69	3.6	0.5
Prizren	52,881	633	265	3	12.0	5.01	4.7	1.9
Skënderaj	26,935	450	151	2	16.7	5.61	4.4	5.5
Shtime	6,310	111	124	1	17.6	19.65	9.0	-21.7
Shtërpçë	56,293	666	316	3	11.8	5.61	4.5	0.6
Suharekë	104,338	1526	572	15	14.6	5.48	9.8	3.7
Ferizaj	48,013	542	242	2	11.3	5.04	3.7	1.2
Viti	60,888	977	375	4	16.0	6.16	4.1	3.7
Vushtri	5,464	57	37	0	10.4	6.77	0.0	-3.1
Zubin Potok	7,182	49	70	0	6.8	9.75	0.0	-12.7
Zveçan	55,819	741	218	4	13.3	3.91	5.4	5.5
Malishevë	5,414	32	28	0	5.9	5.17	0.0	-4.4
Junik	5,804	77	23	0	13.3	3.96	0.0	5.3
Mamushë	10,054	114	41	1	11.3	4.08	8.8	3.2
Hani i Elezit	12,201	148	144	0	12.1	11.80	0.0	-11.5
Graçanicë	3,732	27	43	0	7.2	11.52	0.0	-15.8
Ranillug	1,660	24	36	0	14.5	21.69	0.0	-28.9
Partesh	2,687	38	28	0	14.1	10.42	0.0	-6.7
Kllokot	11,882	156	133	0	13.1	11.19	0.0	-9.3
Gjithsej	1,762,220	22632	9845	117	12.8	5.6	5.2	7.3

Burimi: ASK, Vlerësim popullsia e Kosovës, 2022

Statistikat e Lindjeve dhe statistikat Vdekjeve, 2022

Shënim: Indikatorët janë llogaritur bazuar në numrin e banorëve të parashikuar nga ASK që mund të ketë ndryshim nga vlera reale